



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM  
Nr.40, datë 27.01.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME  
KORÇË SH.A.

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "*Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence*" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "*Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 27.01.2021 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: Mbi miratimin e vendimit "Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Korçë sh.a.",

**Vëren se:**

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Korçë (**UK Korçë**) me shkresën nr. 361 prot. ERRU, datë 18.12.2020 si dhe plotësimet me shkresë përcjellëse nr.12 prot, datë 12.01.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Korçë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 63 datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" (**VKM nr. 63**).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

- a) Shoqëria UK Korçë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 112 548 banorë të Bashkisë Korçë;
- b) Drejtues teknik i shoqërisë z. Pandi Qirinxhi është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së ndërtimit, Dega Gjeodezi në vitin 1985 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.
- c) Drejtues teknik i shoqërisë për Impiantin e përpunimit të ujërave të ndotura z. Aleks Andoni është diplomuar në Universitetin e Tiranës, në degën Kimi industriale në vitin 1993 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Korçë, të:

- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
- b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Korçë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

#### **VENDOSI:**

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a me (NUIS J64103141O), në kategoritë:
  - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
  - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura
  - c) Kategoria D - Për trajtimin e ujërave të ndotura
2. Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues Ligjor – Petrit Tare
- b) Drejtues Teknik – Pandi Qirinxhi
- c) Drejtues Teknik – Aleks Andoni

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Korçë sh.a është Bashkia Korçë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Korçë sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Korçë sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Ndriçim Shani**